

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

**Auditim i avancuar dhe
siguria**

(Zgjidhjet)

P10

Shënim: Emrat e individëve, vendeve dhe kompanive, të përdorura në këtë provim janë fiktive. Çdo ngjashmëri është plotësisht e rastësishme

Data 27/01/2024

Detyra 1

(a) Ju jeni menaxher i auditimit në firmën BeBe-Audit, përgjegjës për auditimin e Solofar, kompani që prodhon panele të energjisë diellore. Kjo është hera e parë që po menaxhoni një klient të auditimit, pasi që keni marr detyrën nga Meti, menaxheri i mëparshëm. Planifikimi i auditimit për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022 është duke filluar dhe ju keni pranuar korrespondencën nga takimi me drejtorin financiar të kompanisë, Arbenin:

Komentet e Arbenit gjatë takimit tuaj:

Vështrim i përgjithshëm mbi kompaninë

Aktiviteti kryesor i biznesit të Solofar mbetet prodhimi i panelëve. Njëri nga materialet kyçe që përdoret në prodhimin e panelave është silikoni i cili importohet. Si një masë për zvogëlimin e kostove, në maj të vitit 2022, është nënshkruar një kontratë me një furnitor jashtë vendit dhe tani të silikoni importohet sipas kësaj kontrate të furnizimit. Blerjet bëhen me valutë të huaj, por kompania nuk përdor kontrata foruad (për fiksimin e çmimit dhe datës) lidhur me këto importe. Solofar ka dy fabrika të prodhimit, njëra prodhon produkte për eksport ndërsa tjetra për tregun vendor. Rreth gjysma e produkteve të kompanisë eksportohen, mirëpo tregu i eksportit është duke u ballafaquar me vështirësi për shkak të konkurrencës nga prodhues të lirë nga jashtë. Shumica e shitjeve vendore bëhen përmes kontratave me rreth 20 konsumatorë.

Zhvillimet e fundit

Në fillim të dhejtorit 2022, fabrika që prodhon për tregun vendor kishte ndërprerë prodhimin për një javë. Një numër i konsumatorëve kishin kthyer mallrat, duke u ankuar se kishte defekte në panelet solare. Gjatë inspektimit, është zbuluar se qelizat në panelet solare nuk prodhonin energjinë e duhur për shkak të cilësisë së dobët të silikonit. Vlerësimi i cilësisë së silikonit mund të bëhet vetëm përmes pajisjeve të specializuara dhe nuk mund të vërehet me sy. Të gjithë konsumatorët janë kontaktuar menjëherë dhe nëse ishte e nevojshme produktet janë tërhequr dhe zëvendësuar. Stoqet e silikonit me cilësi të dobët janë identifikuar dhe janë ndarë nga stoqet tjetër. Së voni ka filluar linja e re e prodhimit e cila do të sigurojë se kompania përmbushë kërkesat e reja rregullatore që ndalon përdorimin e disa kimikateve, e cila rregullore hyn në fuqi në shkurt të vitit 2023. Në qershor 2022, është negociuar një hua nga banka prej €30 milion me një interes 4%. Qëllimi kryesor i kredisë ishte financimi i shpenzimeve kapitale të nevojshme për linjën e re të prodhimit. €2.5 milion e huasë përfaqëson një mbitërheqje e cila ishte konvertuar në financim afatgjatë.

Çështje tjera

Disa nga drejtorët ekzekutiv të Elkofar si dhe shefi i kontabilitetit kanë ikur nga kompania në shtator 2022, për të themeluar një kompani të specializuar në riciklimin e pajisjeve të vjetra elektronike. Kjo kompani e re nuk konsiderohet konkurrencë e Elkofar. Drejtorët u larguan në mënyrë miqësore nga kompania dhe ndërkohë Elkofar kishte rekrutuar drejtorët tjerë për të zëvendësuar këto pozita.

Informatat financiare të ofruar nga kompania të pasqyrës së ta ardhurave draft për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022

	2022 draft '000	2021 aktuale '000
Të hyra	12,500	13,800
Kosto operative	(12,000)	12,800
Fitimi operativ	500	1,000
Kosto financiare	(800)	(800)
Fitimi/(humbja) e vitit	(300)	200

Drafti i pasqyrës së pozicionit financiar nuk është përgatitur ende por Arbeni thekson se pasuria gjithsej me 31 dhjetor është €180 milion dhe paraja në bankë është €130,000. Bazuar në shifrat draft, koeficienti qarkullues është 1.1 dhe koeficienti i shpejtësisë është 0.8.

Kërkohet:

- (i) Vlerësoni rreziqet e binzesit me të cilat ballafaqohet Solofar; (15 pikë)**
- (ii) Identifikoni dhe shpjegoni PESË rreziqe të anomalive materiale që duhet të konsiderohen gjatë planifikimit të auditimit; dhe (10 pikë)**

(Gjithsej 25 pikë)

Zgjidhja

Hyrje

Kjo letër paraqet rreziqet biznesore të kompanisë dhe identifikon dhe shpejgon katër rreziqe të anomalive materiale që duhet të konsiderohen në fazën e planifikimit të auditimit të kompanisë për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2022.

(i) Rreziqet biznesore

Mallrat e importuara – luhatjet në këmbimet valutore

Solofar mbështetet në përbërës të prodhimit që importohen nga jashtë. Kjo e ekspozon kompaninë ndaj luhatjes së çmimieve për shkak të normës së këmbimit valutor. Kompania nuk përdor kontrata foruad për të zvogëluar këtë rrezik që mund të mos jetë strategji e mençur për një biznes që mbështetet në import. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor po ashtu mund të shkaktojnë luhatjet në fitimin e kompanisë.

Mallrat e importuara – çështjet me transportin

Mbështetja e madhe në import do të thotë edhe rritje të kostonë së transportit. Gjithashtu mund të ketë pengesa në probleme me avionë. Si rezultat mund të ketë mungesë të stokeve një kohë dhe kështu pengesa në prodhim. Përveç nëse kompania mban nivel të arsyeshëm të stokeve për të adresuar vështirësitë me transportin, kjo mund të shkaktojë problem me reputacionin.

Mbështetja në një furnitor të vetëm

I gjithë teli i bakrin vjen nga një furnitor jashtë vendit. Ky nivel i mbështetjes është tepër me rrezik dhe çfardo pengese nga ana e furnitorit do të reflektohet edhe në kompaninë Lenjani.

Çështjet me kontrollin e cilësisë

Që nga përzgjedhja e furnitorit, kompania është duke u ballafaquar me cilësi të dobët të lëndës së parë që mund të rezultojë me humbjen e konsumatorëve. Ndryshimi i furnitorit mund të ketë qënë rezultat i zvogëlimit të kostove, mirëpo zgjidhja e problemit të cilësisë mund të jetë më problematike për shkak të largësisë me furnitorin. Mund të ketë kosto shtesë për të siguruar cilësinë e duhur psh kosto e testimit shtesë. Marzha operative e kompanisë tashmë është mjaft e ulët vetëm 4% (2021 – 7.2%), prandaj kosto shtesë do ta zvogëlojë këtë marzhë edhe më tutje.

Teknologjia e lartë dhe konkurrenca e madhe

Solofar shet në një industri me teknologji të lartë, duke konsideruar se pasijet e tilla zhvillohen shumë shpejtë. Ka mundësi që kompania ka nevojë të adaptohet shumë shpejtë me kërkesat në rritje të tregut, por mund të mos ketë burime për të adresuar këtë. Po ashtu Solofar operon në një industri shumë konkurruese dhe shumë furnitorë mund të ndjekin konsumatorët e njëjtë që do të thotë se ka presion mbi çmimet. Siç u diskutua më sipër marzha operative e kompanisë është tashmë e ulët dhe zbritja në çmime mund të shkaktojë probleme të mëtutjeshme.

Mbështetja në konsumatorët kyç

Solofar mbështet në vetëm 20 konsumatorë për të gjeneruar të hyra nga tregu vendor i cili treg gjeneron rreth 50% të të hyrave të kompanisë. Në një treg konkurrues, do të jetë e vështirë mbajtja e konsumatorëve pa i zbritur çmimet, që do të bëjnë presion të mëtutjeshëm në fitim. Çështja tjetër është se problemi me cilësinë tashmë mund të ketë shkaktuar ikjen e ndonjërit prej konsumatorëve pavarësisht veprimin e kompanisë për të zëvendësuar produktet.

Çështjet rregullatore

Rregullativa e re hyn në fuqi pas disa muajsh. Duket se fabrikat momentalisht nuk janë në pajtueshmëri me kërkesat rregullatore prandaj ka filluar ndërtimi i vijave të prodhimit që do të jenë në pajtueshmëri. Kjo çështje shkakton rrezik domethënës të pajtueshmërisë që mund të çojë drejt hetimit nga agjencitë rregullatore dhe mund të rezultojë me gjoba e ndëshkime si dhe reputacion të keq. Gjithashtu ka kosto shtesë të monitorimit dhe kosto për shpenzime kapitale.

Financimi shtesë – çështje me likuiditetin

Është marrë një kredi që përfaqëson 16.7% të pasurive gjatë vitit. Kjo është një shumë materiale që do të rrisë leverazhin e kompanisë dhe rritje të obligimit për të paguar interesin që është 1.2 milion në vit si dhe ripagesa e kredisë në të ardhmen. Kompania nuk duket se ka shumë para, me vetëm €130,000 para të gatshme dhe një mbitëheqje prej €2.5 milion, kapitali qaarkullues mund të jetë

problem afatgjatë i kompanisë. Koeficienti qarkullues dhe i shpejtësisë po ashtu tregojnë se kompania ka problem në kthimin e borxheve me kohë.

Profitabiliteti

Pasqyra draft e të ardhurave tregon se të hyrat kanë rënë me 9.4% dhe fitimi operativ ka rënë me 50%. Në përgjithësi kompania ka gjeneruar humbje për vitin aktual. Në vitin 2022 kostot financiare nuk janë mbuluar nga fitimi operativ dhe duket se këto kosto ende nuk përfshijnë interesin e kredisë së re të cilat do të jenë €500,000 ($€30m \times 4\% \times 5/12$). Përfshirja e koston shtesë do të rrisë humbjen në €800,000. Ky mund të jetë tregues për problem me vijimësinë.

Ndrrimet në menaxhmentin kyç

Humbja e disa drejtorëve gjatë vitit është rrezik biznesor dhe kompania mund të humb aftësitë kryesore dhe përvojën.

(ii) Rreziqet e anomalive materiale

Transaksionet në valutë të huaj – njohja fillestare

Shumica e bakrit importohet që çon në rrezik të trajtimi kontabël për transaksionet me valutë të huaj. Sipas SNK 21 Efektet e ndryshimeve në normat e këmbimit valutor, valuta e huaj në fillim duhet të njihet duke përdorur normën e datës së transaksionit ose normën mesatare nëse valuta nuk luhet në mënyrë domethënëse. Nëse kompania nuk përdorë këtë normë si duhet, kjo mund të shkaktojë shpenzime të pasakta, detyrime dhe stoqe të pasakta.

Transaksionet në valutë të huaj – fitimi dhe humbja nga këmbimi

Një rrezik tjetër është trajtimi kontabël i saldove në valutë të huaj në fund të vitit. Të pagueshmet në valutë të huaj duhet të ripërkthehen në fund të vitit sipas valutës në fund të vitit dhe duke njohur çfardo fitimi ose humbje nga transaksioni. Rreziku është se nëse ky ripërkthim nuk ndodhë në fund të vitit, mund të shkaktojë nën/mbi vlerësim të llogarive të pagueshme dhe shpenzimeve operative. Gjithashtu pagesat që janë bërë gjatë vitit nëse nuk janë përkthyer si duhet mund të shkaktojnë gabime në fitim dhe humbje nga këmbimi valuator.

Tërheqja e produkteve – stoqet e dala jashtë përdorimit

Ekziston një sasi e silikonit që duhet të sjellet në vlerën e saj të neto të realizueshme për shkak të cilësisë së dobët dhe nuk mund të përdoret në produkte. Stoqet duhet të vlerësohen sipas SNK 2, matja sipas koston ose VNR cilado që është më e ulët. Nëse stoqet nuk sjellen në VNR atëherë ato mund të jenë të mbivlerësuara në fund të vitit. Rreziku rritet edhe më tutje për shkak të pamundësisë së kompanisë të vërej me sy cilësinë e lëndës së parë por vetëm përmes testimit elektrik me pajisje të specializuara.

Tërheqja e produkteve – rimbursimi i konsumatorëve

Për shkak të produkteve të dëmtuara ka gjasë që disa konsumatorë të kërkojnë rimbursim të pagesave në vend të zëvendësimit të produktit. Nëse pagesa është kryer, kompania duhet të njeh një provizion për vlerën e rimbursimit. Nëse konsumatori nuk ka paguar ende për mallrat e dëmtuara, atëherë saldoja e llogarisë së arkëtueshme te ata konsumatorë duhet të shlyhet. Varësisht a ka paguar apo jo konsumatori, gabimet në trajtimin kontabël të këtyre rimbursimeve mund të shkaktojnë mbivlerësim të fitimeve në fund.

Financimi shtesë – kapitalizimi i vijës së re të prodhimit

Procesi i ri i prodhimit duket të jetë një shpenzim domethënës kapital dhe është me rëndësi që kompania ta trajtojë atë në pajtueshmëri me SNK 16 Prona, impinatet dhe pajisjet si dhe SNK 32 Kosto e huamarrjes. Kosto financiare që shpërndahet direkt në këto makineri duhet të kapitalizohet përgjatë periudhës së ndërtimit të linjës së prodhimit dhe nëse nuk kapitalizohet atëherë pasuria joqarkulluese mund të jetë nënvlerësuar. Po ashtu ka rrezik që për shkak të presionit të fitimit, kompania të nënvlerësojë shpenzimet, kjo do të arrihej përmes trajtimit të zërave të shpenzimit si zëra kapital dhe kështu të mbivlerësohet fitimi.

Rregulloret e reja – vlerësimi i fabrikave dhe linjave ekzistuese të prodhimit

Ka rrezik që linjat ekzistuese të prodhimit të jenë dëmtuar (humbje në vlerë). Për shkak të rregullores së re këto linja të prodhimit nuk do të përdoren prandaj kompania duhet të trajtojë ato në pajtueshmëri me SNK 36 Dëmtimi i pasurive. Sipas këtij standardi kompania duhet të ndërmerr

rishikime për dëmtimet e mundshme dhe të identifikoj shumën e rikuperueshme. Nëse nuk bëhet ky rishikim, pasuria mund të jetë e mbivlerësuar.

Financimi shtesë – matja dhe shpalosja e kredisë

Kredia e marr nga banka është një detyrim financiar i cili duhet të matet sipas SNRF 9 Instrumentat Financiar, i cili thekson se detyrimet financiare duhet të klasifikohen dhe maten sipas kostos së amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv (përveç nëse është vendosur më parë të përdoret vlera e drejtë). Ka rrezik që kosto e amortizimit nuk është aplikuar që do të thotë se kosto financiare nuk është paraqitur si akruale. Fakti që kosto financiare në draft pasqyrat financiare ka mbetur e njëjtë nga viti i kaluar do të thotë se ka nënvlerësim të kostos financiare dhe detyrimeve. Po ashtu ka rrezik që shpalosjet nuk janë bërë sipas SNRF 7 Instrumentat financiar: Shpalosjet. Shënimet e pasqyrave financiare duhet të përmbajnë shpalosje narrative dhe numerime lidhur me ekspozimin ndaj rrezikut dhe duke marr parasysh materialitetin e kredisë, ka mundësi që një shpalosje e tillë të jetë e nevojshme.

Përfundimi

Auditimi i Solofar duhet të konsiderohet si auditim me rrezik të lart për shkak të një numri të konsiderueshëm të rreziqeve biznesore dhe rreziqeve të anomalive materiale. Duhet të zhvillohet një strategji e auditimit për të zvogëluar rrezikun e përgjithshëm të auditimit si dhe duhet të respektohen procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë tërë auditimit. Përveç kësaj, çështja etike e menaxherit të auditimit duhet të paraqitet tek partneri i etikës së firmës sa më parë të jetë e mundshme.

Detyra 2

Lorena ShA është një grup i kompanive të shumëllojshme që është i përfshirë në aktivitete të ndryshme. Pasqyrat financiare draft për vitin që përfundoi me 31 mars 2022 paraqiten më poshtë:

Ekstrakt i pasqyrave	2022 draft	2021 (të audituara)
financiare	€milion	€milion
Të hyrat	25.5	23.4
Fitimi para tatimit	2.6	2.5
Pasuri neto	24.8	22.7

Ju jeni menaxheri i auditimit përgjegjës për auditimin e vitit që përfundon me 31 mars 2022. Sapo keni vizituar vendndodhjen e klientit dhe jeni duke rishikuar punën që është kryer deri me sot. Seniori i auditimit ju ka lënë shënimet në vijim për tu konsideruar nga ju:

(a) Lorena ka blerë një pronë në prill të vitit 2021 me një kosto €2.2 milion. Prona nuk ishte në gjendje të mirë mirëpo Lorenës i nevojiteshin hapësira për zyra shumë shpejtë, prandaj e kishte zhvendosur disa nga stafin administrativ në ato hapësira menjëherë. Në janar 2022, u bënë të gatshme dhe disa hapësira dhe kështu kompania rilokojë edhe stafin tjetër. Ishte marrë vendim për ta shitur atë pronë. Prandaj ishte vendosur të mos llogaritet ndonjë zhvlerësim për atë pronë për vitin që po auditohej. Mirëpo, ishte nevojitur një punë domethënëse riparuese para se shitja të përfundonte. Kjo punë kishte filluar në shkurt 2022. Kosto e punës ishte paraqitur si shpenzim i riparimit dhe mirëmbajtjes. Prona kishte një çmim të rezervuar në ankand prej €3.5 milion, ankandi është paraparë të ndodhë me 30 qershor 2022. Prona është klasifikuar si 'E mbajtur për shitje' në fund të vitit sipas *SNRF 5 Pasuritë joqarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera* në vlerë prej 3.5 milion dhe një fitim prej 1.3 milion është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe të hyrave tjera gjithëpërfshirëse. **(9 pikë)**

(b) Në janar 2022, Lorena ka blerë 53% të aksioneve të GH ShA për €1.7 milion. Kompania është trajtuar në kontabilitet si investim në shoqëri (filial) dhe rezultatet nuk janë konsoliduar. Drejtori financiar i grupit i ka dhënë dy arsye për këtë trajtim. E para, aktivitetet e GH ShA janë shumë të ndryshme nga ato të pjesës tjetër të grupit, dhe e dyta, nuk është integruar ende sistemi financiar i GH me pjesën tjetër të grupit. **(7 pikë)**

(c) Me 12 mars 2022, ka ndodhur një eksplodim në një nga ndërtesat e Lorena, duke shkatërruar një të katërtën e saj. Fatëmirësisht, eksplodimi kishte ndodhur natën dhe askush nuk ishte lënduar. Inxhinierët dhe vlerësuesit aktualisht janë duke e vlerësuar stabilitetin e ndërtesës dhe ende nuk është e qartë nëse ndërtesa do të mund të riparohet apo do të shembet në tërësi dhe të rindërtohet. Në ditët e fundit, është pranuar një lajmërim nga pronarët e ndërtesave në afërsi të cilët pretendojnë se struktura e ndërtesave të tyre është dëmtuar nga eksplodimi. Ata poashtu treguan se aktualisht janë duke vlerësuar dëmin dhe stabilitetin e ndërtesave përmes inxhinierëve dhe vlerësuesve. Këta pronarë kanë njoftuar zyrtarisht kompaninë Lorena se nëse eksplodimi ka ndikuar negativisht në ndërtesat e tyre, ata do të kërkojnë dëmshpërblim 'të përshtatshëm dhe të arsyeshëm' nga kompania. Kompania e sigurimit të Lorena është informuar për këtë ngjarje dhe janë duke refuzuar të komentojnë deri sa të jenë të qarta faktet dhe efektet e ngjarjes. **(9 pikë)**

Kërkohet:

Lidhur me secilën nga çështjet e mësipërme, vlerësoni në mënyrë kritike çështjet që duhet të konsiderohen dhe dëshimitë e auditimit që ju prisni ti gjeni gjatë auditimit të pasqyrave financiare të Loni për vitin që përfundoi me 31 mars 2022.

[Total: 25 Pikë]

Përgjigja

Çështjet që duhet të konsiderohen

- Materialiteti: qështja është materiale. Kosto e pronës së blerë është gati 8.9% e pasurive totale dhe fitimi i njohur është 50% i fitimit para tatimit.
- Rreziku i anomalive materiale ka të bëjë me vlerën bartëse të pasurive joqarkulluese dhe shpenzimeve/të hyrave në pasqyrën e të ardhurave.
- Prona është klasifikuar gabimisht si 'e mbajtur për shitje'. SNRF 5 thekson se që një pasuri të klasifikohet i 'e mbajtur për shitje', ajo 'duhet të jetë e gatshme për shitje të menjëhershme në kushtet e tanishme'. Ashtu siç shihet, puna ende është duke vazhdua prandaj kjo pasuri nuk mund të klasifikohet si e mbajtur për shitje. Ajo duhet të riklasifikohet si pjesë e pasurive joqarkulluese.
- Prandaj fitimi prej €1.3 milion nuk është dashur të regjistrohet dhe pasuria është dashur të zhvlerësohet për atë vit.
- Do të ishte e papërshtatshme të paraqitet si shpenzim i riparimit dhe mirëmbajtjes sepse natyra e ketyre shpenzimeve është më shumë kapitale për nga natyra, sidomos duke konsideruar qëllimin për ta shitur pronën.

Dëshmitë e auditimit:

- Kontrata e blerjes ose fatura
- Dëshmi mbi pagesën e kryer (transfer bankar)
- Dëshmi të përgatitjes së ndërtesës për tu shfrytëzuar nga kompania
- Procesverbalët e takimit që autorizojnë blerjen dhe më pas edhe shitjen e ndërtesës.
- Faturat dhe dëshmitë tjera lidhur me shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes.

(b) Çështjet për konsiderim

Ky duket të jetë transaksion material që paraqet gati 6.9% të pasurive totale.

- Përveç nëse ka rrethana të pazakonta që nuk janë përmendur në rast, mbajtja e 53% të aksioneve do të thotë se kompania ka kontroll mbi GH, prandaj duhet të trajtohet si degë për konsolidim.
- Asnjëra nga arsyet e drejtorit financiar nuk është e vlefshme për moskonsolidim. E vetmja arsye për moskonsolidim do të ishte nëse kompania është blerë për tu rishitur dhe kontrolli do të konsiderohej si i përkohshëm.
- Sipas rrethanave, regjistrimet në kontabilitet duhet të korrigjohen dhe kompania duhet të konsolidohet me mëmën.

Dëshmitë e auditimit

- Dëshmi të blerjes dhe pagesës së aksioneve.
- Shënimet e takimeve të bordit në të cilat autorizohet mblerja e kompanisë.
- Dokumentet siç janë regjistri i aksioneve dhe hulumtimi në databazë për verifikimin e numrit të aksioneve të blera për të vërtetuar se blerësi është aksionarë shumicë.
- Letrat e punës që tregojnë trajtimin sipas metodës së ekutiteti dhe më pas sipas metodës së blerjes (llogaritja e zërit të mirë siç kërkohet me SNRF 10 dhe SNRF 13)

(c) Çështjet që duhet të konsiderohen

- Kjo ngjarje ka ndodhur para fundit të periudhës prandaj duhet të reflektohet në PF për vitin që po auditohet.
- Eksplodimi do të thotë se prona dhe pasuritë tjera duhet të rishikohen për dëmtim sipas SNK 36.
- Gjithashtu është krijuar një detyrim i mundshëm ndaj pronarëve tjerë që pretendojnë këtë. Kjo duhet të kuantifikohet dhe të shpaloet në PF edhe pse aktualisht ka shumë pasiguri prandaj shpaloja mund të mos kërkohet (SNK 37).

- Duhet të rishikohet kontrata me kompaninë e sigurimit për mundësinë e mbulimit të dëmit dhe trajtimit në kontabilitet.

Dëshmitë e auditimit

- Detajet e incidentit, raportet nga autoritetet siç janë policia, kompania e sigurimit, etj
- Raportet paraprake nga vlerësuesit dhe inxhinierët
- Të gjitha korrespondencat me kompaninë e sigurimeve përfshirë polisën e sigurimit dhe dëshmi nëse është paguar ndonjë shumë deri në këtë datë.
- Lajmërimin nga pronarët e bizneseve tjera dhe kopjet e çfardo korrespondence me ata.
- Procesverbalet e takimeve të bordit në të cilat është diskutuar çështja. Në veçanti, shkaku i incidentit dhe mënyrat se si mund të parandalohet në të ardhmen.

Detyra 3

(A) Klineti juaj i auditimit "M" Shpk është një prodhues i madh farmaceutik. Kompania ka një pjesë të konsiderueshme të tregut të barit gantramol që shitet me emrin M-Gantra.

Së voni, një numër i madh i konsumatorëve kanë kërkuar ndihmë të mjekut për shkak të efektit nga M-Gantra. Është zbuluar se kjo kishte ndodhur për shkak se përbërja gjatë prodhimit ishte ndryshuar me qëllim.

Kërkohet:

Nga informatat e ofruara për kompaninë M:

(a) Duke supozuar se hipoteza e vijimësisë nuk është problematike, identifikoni tri llogari të pasurive që mund t'i ekspozohen rrezikut. (3 pikë)

(b) Për secilin nga këto 3 llogari të identifikuar:

- (i) Ofroni një analizë të shkurtër pse është llogari me rrezik;
- (ii) Tregoni pohimin relevant në të cilin duhet të fokusohet puna e auditimit; dhe
- (iii) Ilustroni një test të detajeve i cili duhet të kryhet për të grumbulluar dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit lidhur me pohimin e identifikuar nën (b) më sipër. (12 pikë)

(c)

- (i) Identifikoni një llogari të pasqyrës së të ardhurave i cili NUK është i lidhur me llogaritë e identifikuar më sipër;
- (ii) Ofroni një analizë të shkurtër pse është llogari me rrezik;
- (iii) Tregoni cili pohim është relevant për atë llogari me rrezik (3 pikë)

(B) Një klient tjetër i auditimit, një bankë e madhe, ka marrë një vendim strategjik për të racionalizuar aktivitetet operative të saj duke mbyllur një numër të degëve të bankës gjatë vitit të ardhshëm financiar. Ju keni identifikuar llogarinë "provizionet për punëtorët e larguar" si llogari me rrezik të lartë për vitin aktual financiar. Ju keni vendosur që puna e auditimit të fokusohet në pohimet e plotësisë dhe vlerësimit.

Kërkohet:

Për secilin nga pohimet, plotësia dhe vlerësimi:

(a) Analizoni shkurtër pse është pohim kyç; dhe (4 pikë)

(b) Përshkruani nga një procedurë thelbësore për të grumbulluar dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit për këto dy pohime. (3 pikë)

[Total: 25 Pikë]

Zgjidhja

a) Llogaria e pasurive	b) i) Shpjegimi	b) ii) Pohimi	Testet
1. Stoqet	Sigurohu se të gjitha stoqet e tërhequra nga tregu janë sjellur në vlerë zero	Vlerësimi	Identifikoni të gjitha stoqet që kanë të bëjnë me periudhën e helmimit dhe sigurohuni se janë shlyer ose sjell në vlerën zero
	Ose E pamundur të shiten stoqet për shkak të publicitetit të keq	ose Vlerësimi	ose Përcaktoni nëse stoqet duhet të shlyhen ose të sjellen në VNR
2. Llogaritë arkëtueshme	e Konsumatorët mund të mos pajtohen me kthimet e stokeve dhe mund të refuzojnë të paguajnë për mallrat jashtë periudhës së ngjarjes	Vlerësimi	Rishikoni vjetërsinë e LLA të kundërshtuara. Rishikoni korrespondencat, bëni pyetje, rishikoni inkasimet e mëvonshme për të siguruar se shumat e dyshimta duhet të provizionohen.
	Ose Sigurohuni se të gjitha shitjet me kredi janë agjustuar pas ngjarjes	ose Ekzisteca	Sigurohuni se të gjitha shitjet e tërhequra janë regjistruar. Gjurmoni notat e kreditit për stoqet dhe LLA për shitjet e tërhequra.
3. Emri i brendit	Tërheqja e shitjeve dhe mallrave mund të ketë efekt afatgjatë mbi emrin e kompanisë dhe shitjet në të ardhmen prandaj duhet të konsiderohet vlera e brendit	Vlerësimi	Përcaktoni ndikimin e mundshëm të shitjeve në të ardhmen duke diskutuar me menaxhmentin, opinionin nga ndonjë vlerësues i pavarur dhe përcaktoni nëse emri i brendit duhet të sjellet në vlerë tjetër më të ulët.

c)

Llogaria e shpenzimeve	Shpjegimi – pse rrezik	Pohimi
Kosto e padive (kosto ligjore dhe/ose kosto lidhur me helmimin e konsumatorëve)	Ka gjasë të madhe që konsumatorët e helmuar do të padisin kompaninë duke kërkuar komenzim për kosto spitalore si dhe humbje të të hyrave	Plotësia
Ose	Ose	Ose
Kosto e tërheqjeve të produkteve nga tregu	Këto kosto ka gjasë të jenë të mëdha	Plotësia
Ose	Ose	Ose
Kosto e largimit ngapuna të punonjësve	Mbyllja e përkohshme e fabrikave	Plotësia
Ose	Ose	Ose
Kostot e promovimit dhe reklamimit që mund të jenë kapitalizuar më herët	Reklamat e parapaguara lidhur me produktet që janë tërhequr nga tregu	Plotësia

(B)

Pohimi	Pse është pohim kyç	Testet
Plotësia	Duhet të sigurohemi se të gjithë të punësuarit dhe kostot e tyre përkatëse përfshihen në provizione	Përzgjidhni një mostër të të punësuarve nga lista e pagave dhe ndjekini deri në llogaritë e provizioneve
Vlerësimi	Dhet të sigurohemi se të gjitha kostot janë regjistruar me shuma të sakta. Llogaritjet ka gjasë të jenë komplekse duke u siguruar se	Përzgjedh një mostër të të punësuarve dhe kontrollo arsyeshmërinë e kostove të largimit nga puna të të punësuarve dhe ndjekini deri te dokumentet mbështetëse, siç janë kontratat e punës, etj.

Detyra 4

(a) Ju jeni menaxher i auditimit të klientit Rapanui Shpk, një kompani që shet mobilje me pakicë. Përmbledhja e shifrave draft dhe të audituara është siç vijon:

	2022 (draft)	2021 (të audituara)
	Milion €	Milion €
Të hyrat (për vitin deri me 31 dhjetor)	45.0	43.0
Fitimi para tatimit (për vitin deri me 31 dhjetor)	2.0	1.5
Pasuritë totale (me 31 dhjetor)	31.0	24.0

Pikat në vijim duhet të konsiderohen gjatë draftimit të raportit të auditimit.

1. Rapanui ShPK merr me qira njërën nga lokalet kryesore nga një kompani që është partneritet me drejtorin ekzekutiv të kompanisë. Rishikimi juaj i kontratës së qirasë tregon se shpenzimi i qirasë së kompanisë Rapanui është përafërsisht €50,000 më shumë se çmimi i tregut sipas 'gjatësisë së krahut'. Rapanui ka refuzuar të shpalos këtë tranaksion në mes palëve të lidhura në shënimet e pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022.

2. Rapanui ka një degë të vogël në një shtet të Evropës Lindore. Që nga 1 janar 2022 ligji i këtij shteti nuk lejon bartjen e fitimeve nga dega tek mëma. Si rezultat i këtij ndryshimi ligjor, Rapanui ka vendosur të trajtojë degën në bazë të ekuitetit për këtë vit. Ju jeni i kënaqur me trajtimin kontabël nga kompania dhe me shpalosjen e mjaftueshme të bërë në pasqyrat financiare për këtë trajtim.

3. Gjatë auditimit, ju keni zbuluar se stoqet me vlerë përafërsisht €1 milion janë përjashtuar nga pasqyrat financiare të kompanisë. Pas diskutimit me menaxhmentin ju jeni i kënaqur me arsyetimin e menaxhmentit se ky veprim ishte i paqëllimshëm. Gabimi ishte korrigjuar para përfundimit të auditimit.

Kërkohet:

Vlerësoni implikimet e këtyre çështjeve në:

(i) Raportin e auditimit për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022. **(14 pikë)**

(ii) Vazhdimin e marrëdhënies tuaj me kompaninë Rapanui Shpk. **(2 pikë)**

(b) Bëni dallimin në mes të termave të mëposhtme ashtu siç përdoren në SNA 700 *Raporti i auditorit të pavarur mbi pasqyrat financiare*; SNA 705 *Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit të pavarur*; dhe SNA 706 *Paragrafët e theksimit të çështjed dhe paragrafët tjerë në raportin e auditorit të pavarur*, dhe ofroni një shembull se si mund të përdorej secili në praktikë.

(i) Refuzimi (mohimi) i opinionit KUNDREJT opinionit kundër

(ii) Paragrafi i theksimit të çështjes KUNDREJT paragrafi i çështjeve tjera

(iii) Raporti i pamodifikuar KUNDREJT opinionit të pamodifikuar. **(9 pikë)**

[Total: 25 Pikë]

Zgjidhja

(a)

1. Sa i përket shumës prej €50,000, ajo është vetëm 2.5% e fitimit para tatimit dhe 0.11% e të hyrave prandaj kjo shumë mund të quhet jomateriale. Mirëpo, ky nuk është tregimi në tërësi.

Së pari, edhe nëse nuk do të kishte mbipagesë prej 50,000, ky është një transaksion me palë të lidhura prandaj duhet të shpaloset sipas SNK 24. Çështja do të konsiderohet jomateriale, sipas SNK 24. Vetëm nëse do të ishte jomateriale për të dy palët e transaksionit. Kjo do të ishte e mjaftueshme që të rezervohej opinion me “përveç për”.

E dyta, mbipagesa mund të shihet si kompenzim shtesë për drejtorin dhe pasoja në këtë rast do të ishte e dyfishtë. E para, do të duhej të shpallosej si kompanzim i drejtorit në pajtueshmëri me kërkesat ligjore të bursave (nëse kompania është e regjistruar) dhe e dyta mund të ketë pasoja tatimore.

Në secilin rast, transaksioni dhe vet sjellja e drejtorit do të paraqet pengesë për firmën e auditimit për të vazhduar marrëdhënien me këtë klient.

2. Nga kjo duket se nuk ka nevojë për ndonjë shtesë në raportin e auditimit dhe nuk duket se ka ndikim në marrëdhënien e auditorit në të ardhmen. Nëse kjo do të ishte një degë domethënëse e kompanisë do të kërkohej një paragraf i theksimit të çështjes, por pasi që është një degë e vogël atëherë nuk ka ndonjë pasojë.

3. Duke konsideruar se gabimi ishte korrigjuar pase se pasqyrat financiare të publikohen, është e qartë se nuk ka ndikim në raportin e auditimit pa marrë parasysh që shuma është material (50% e fitimit para tatimit dhe 2.22% e qarkullimit). Sa i përmet vazhdimin të marrëdhënies me klientin, nuk duket se ka ndonjë problem, megjithatë auditori duhet të konfirmoj se si ka ardhur deri te gabimi dhe ndoshta të rivlerësoj rrezikun e kontrollit.

(b)

(i) Mohimi i opinion është i përshtatshëm kur auditori vendos se nuk ka evidence të mjaftueshme të auditimit për të arritur në një konkludim mbi pasqyrat financiare. Kjo mund të ndodhë, për shembull, nëse ka një mangësi të mëdha në llogarimbajtje, ose ka shumë transaksione të padokumentuara me para të gatshme.

Në anën tjetër, opinion kundër jepet kur auditori vjen në konkludim bazuar në evidence, se pasqyrat financiare nuk paraqiten drejt dhe sinqert. Kjo zakonisht vjen si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve përhapëse lidhur me si është zbatuar një standard i kontabilitetit, etj

(ii) Paragrafi i theksimit të çështjes përfshihet atëherë kur auditori don ta thekson ndonjë çështje të caktuar (e cila është shpalosur si duhet në pasqyrat financiare) për përdoruesit e pasqyrave financiare. Në praktikë, ky paragraf përfshihet kur ka dyshime mbi aftësinë e entitetit të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, por auditori konkludon se entiteti është në gjendje të vijojë.

Paragrafi i çështjeve tjera përfshihet kur auditori dëshiron t’i referohet ndonjë çështjeje e cila nuk do të mbulohej me modifikimin e raportit të auditorit ose përmes theksimit të çështjes. Për shembull, auditori mund të përdor paragrafin e ‘çështjeve tjera’ për të treguar se shifrat krahasuese të vitit të mëparshëm nuk janë audituar.

(iii) Një raport i pamodifikuar është raport i plotë standard pa asnjë ndryshim nga raporti standard sipas SNA 700. (I). Opinioni i pamodifikuar i referohet situatës kur nuk ka rezervime në opinionin e auditorit ose nuk ka refuzim ose nuk ka kundërshtim. Një raport me theksim të çështjes ose me paragrafin e çështjeve tjera nuk od të ishte një raport i pamodifikuar por do të ishte opinion i pamodifikuar.